

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA GLLOGOC**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	611-25-5156-5-2-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	N.N.T KORABI
NUI	810248791
Adresa	Qikatovë e Vjetër
Vendi	Drenas
Kodi postar	13000
Numri Telefonit	049393266
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Avdullah Morina
Adresa elektronike	nntkorabi@gmail.com
Data e parashtrimit të kërkesës	19.06.2025

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtrojë kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-i
Adresa elektronike t

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

B05 - Njoftim per Kontrat - 10.06.2025

B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara - 11.06.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtime dhe ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Shkelje të parimeve themelore të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin

Publik,përkatësisht:

Neni 7, paragrafi 1 dhe 2 (Parimi i trajtimit të barabartë dhe ndalimi i diskriminimit),

Neni 28, paragrafi 4 dhe 5

(Specifikimet teknike të pajisjeve nuk duhet të përshkruajnë emër komercial apo karakteristika që mundësojnë identifikimin e pajisjes specifike),

i dhe shkelje të udhëzuesit zyrtar për hartimin e dosjeve të tenderit (versioni 002/2024).

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Ju keni kërkuar një “Cilindër-Valak me gunga 2.7-5 ton për Ekskavator” – kjo kërkesë duhet të anulohet pasi që është kërkuar një makineri që nuk ekziston.

- Keni kërkuar një “Papuqe hidraulike 20-30T” – kjo kërkesë është absurde, pasi që termi në fjalë duhet të specifikohet si papuqe hidraulike që montohet në ekskavator, dhe jo si papuqe më vete me peshë 20-30T. Është e qartë që bëhet fjalë për një paisje ndihmëse për ekskavator me peshë 20-30T, dhe si e tillë duhet të formulohet.

- Keni kërkuar “Dy cilindra hekur-hekur me gjemba me peshë maksimale 1.5 ton” ky është kriter favorizues pasi që sipas standardeve të prodhimit, shumica e

ëtyre cilindrave janë të prodhuar me peshë 2T deri 2.5T. Vendosja e kufizimit maksimum 1.5T është diskriminuese dhe favorizon OE të cilët posedojnë modele të rralla dhe të personalizuar, dhe nuk ka bazë funksionale kur punën e njëjtë e kryen edhe modeli me peshë më të madhe.

- Keni kërkuar “Kamionetë kiper me vinç, dabël kabinë, peshë maksimale të bartjes 750 kg” – ky kriter është i panevojshëm, pasi punën e njëjtë e kryen kamioni kiper me vinç, të cilin ju tashmë e keni kërkuar. Ky është një kriter shtesë pa logjikë teknike.

-Keni kërkuar “Kamioneta kiper 3 copë” – për çfarë nevojë shërbejnë këto makina, kur punën e tyre do ta kryejnë kamionat kiper të cilët tashmë janë të përfshirë në kërkesat e dosjes? Kriter i tepërt dhe i padrejtë që duhet të largohet.

-Keni kërkuar “Ekskavator me peshë maksimale 300kg” – ky kriter duhet të largohet, sepse tashmë keni kërkuar 5 ekskavatorë të tjerë, ku njëri prej tyre duhet të ketë peshë maksimum 900kg. Kjo përforcon bindjen se kemi të bëjmë me një kriter të vendosur për të favorizuar një OE të caktuar.

Keni kërkuar “Pompë betoni statike, me kapacitet të dërgesës minimum 45 m³/orë dhe gjatësi të dërgesës minimum 60 m’ dhe që bartë edhe fraksionin 4 (0.32)” – edhe kjo kërkesë përbën shkelje, pasi që pompa e betonit asnjëherë nuk përdoret për bartjen e fraksionit 4 (0.32). Është kërkesë teknike e pavlefshme dhe dëshmi tjetër për hartim tendencioz të kriterëve.

- Keni kërkuar që “Kompania ofertuese duhet të jetë e certifikuar me ISO 3834-2:2006”, që është një standard specifik për saldimin e materialeve të metalit. Kjo është absolutisht absurde, pasi në paramasën e tenderit nuk ka asnjë pozicion të vetëm që ka të bëjë me saldim ose me trajtim të materialeve metalike. Kjo kërkesë është e papabazë, favorizuese dhe diskriminuese dhe duhet të largohet menjëherë nga dosja e tenderit,

asi nuk ka asnjë lidhje me objektin e kontratës dhe përbën shkelje të parimeve të trajtimit të barabartë dhe proporcionalitetit, në përputhje me nenin 7 dhe nenin 28 të Ligjit për

Prokurimin Publik, si dhe nenin 5.1 dhe 5.6 të Udhëzuesit 002/2024.

KËRKESA JONË:

Kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues:

Të rishikojë urgjentisht dosjen e tenderit,

Të eliminojë kriteret diskriminuese dhe joreale sipas pikave të mësipërme,
ë rifreskojë dokumentet sipas standardeve të barazisë në konkurrencë dhe të harmonizuara me Ligjin e Prokurimit Publik dhe udhëzuesit përkatës.

Për mospërfillje të kësaj kërkesë, do të jemi të detyruar të paraqesim ankesë zyrtare pranë OSHP-së, për shkelje të Ligjit për Prokurim Publik dhe diskriminim të hapur të konkurrencës.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Këto veprime të Autoritetit Kontraktues jo vetëm që kufizojnë pjesëmarrjen tonë të drejtë në këtë procedurë, por potencialisht na shkaktajnë edhe dëme materiale dhe operacionale nëse nuk ndërpritet menjëherë kjo qasje diskriminuese për të cilën kemi përgatitur dokumentacionin konform të gjitha kërkesave ligjore.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) *një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.”*
- b) *një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*